

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
AP.-KŽ. Nr. 189/2012
23 tetor 2012
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen si kryetar i kolegjit, Gjyqtares së Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Gjyqtares së Gjykatës Supreme Nesrin Lushta si anëtare të kolegjit, Në prani të Zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelman, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në seancën e mbajtur më 23 tetor 2012, në lëndën penale kundër të pandehurve:

B.T., me nofkën "**Q.**", emri i babait **Nj.**, emri i nënës **E.**, i lindur më , në , Republika e Serbisë, shqiptar i Kosovës, i pamartuar, ka mbaruar shkollën e mesme, me profesion , me gjendje ekonomike mesatare, me vendbanim në Komuna e Gjilanit, Kosovë, në paraburgim prej 24 shtatorit 2011,

dhe

Nj.T., emri i babait **S.**, emri i nënës **A.**, i lindur më , në in , Republika e Serbisë, shqiptar i Kosovës, i martuar dhe ka fëmijë, ka mbaruar shkollën fillore, me profesion , me gjendje ekonomike mesatare, me vendbanim në fshatin Komuna e Gjilanit, Kosovë, Në paraburgim prej 29 prillit 2011 deri më 29 korrik 2011.

Të akuzuar sipas aktakuzës PP. Nr. 106/11 për veprën penale **Detyrim** në bashkëkryerje, të kryer më 29 prill 2011 në Gjilan në shkelje të nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (tani e tutje "KPK") dhe janë shpallur fajtorë për veprën e lartpërmendur penale me anë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, P. Nr. 188/2012, të datës 7 shkurt 2012 dhe janë dënuar si në vijim: **B.T.** me tre (3) vite burgim dhe **Nj.T.** me dy (2) vite burgim;

Duke vendosur lidhur me ankesat e avokatit mbrojtës **H.M.M.** të paraqitur në emër të pandehurit **B.T.** dhe ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës **M.M.** në emër të pandehurit **Nj.T.** kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, gjithashtu duke marrë parasysh përgjigjen në ankesa të paraqitur nga Prokurori Special i Republikës së Kosovës (PSRK-së) më 21 mars 2012, mendimin e paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK-së) më 21 qershor 2012 dhe parashtresat verbale të bëra nga palët gjatë seancës më 23 tetor 2012,

Lëshon këtë:



AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur në emër të pandehurit **Nj.T.** kundër aktgjykimit P. Nr. 188/2011 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, PRANOHET PJESËRISHT. Aktgjykimi NDRYSHOHET në lidhje me dënimin si në vijim:

I pandehuri **Nj.T.** dënohet me një (1) vit burgim për veprën penale Detyrim të kryer në bashkëkryerje në shkelje të nenit 267 paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së).

Pjesa e mbetur e ankesës REFUZOHET SI E PABAZUAR.

2. Ankesa e paraqitur në emër të pandehurit **B.T.** kundër aktgjykimit të lartpërmendur REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIM

1. Historia e procedurës

Vepra penale e pretenduar është kryer më 29 prill 2011.

Me aktvendimin PPH nr. 106/2011, të datës 1 maj 2011, Prokurori Publik i Qarkut në Gjilan ka filluar hetimet kundër të dy të pandehurve.

Më 20 tetor 2011, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK-ja) ka ngritur aktakuzën PP. Nr. 106/11 kundër **B.T.** dhe të bashkëpandehurit për veprën penale Detyrim të kryer në bashkëkryerje në shkelje të nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 në lidhje me nenin 23 të KPK-së.

Më 9 nëntor 2011, me aktvendimin KA Nr. 181/2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan ka konfirmuar aktakuzën. Të dy të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar përmes 3 seancave më 26 janar dhe 6 dhe 7 shkurt 2012, në prani të Prokurorit të PSRK-së, dy të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës.

Më 7 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan ka shpallur aktgjykimin, duke gjetur **B.T.** dhe **Nj.T.** fajtorë për kryerjen e veprës penale Detyrim të kryer në bashkëkryerje sipas nenit 267 paragrafit 1 në lidhje me nenin 23 të KPK-së dhe ka dënuar **B.T.** me tre (3) vite burgim dhe **Nj.T.** me dy (2) vite burgim.

Me aktvendimin e veçantë P. Nr. 188/2012, të lëshuar në të njëjtën ditë, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Qarkut në Gjilan ka vazhduar paraburgimin kundër të pandehurve deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Më 8 shkurt 2012, avokati mbrojtës i **Nj.T.**, Av. **M.M.**, ka paralajmëruar ankesë.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit *Nj-T*, Av. *H.M.*, më 5 mars 2012 dhe avokati mbrojtës *H.M.* në emër të të akuzuarit *B.T.* më 13 mars 2012 kanë paraqitur ankesa brenga afatit ligjor kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Më 21 mars 2012, Prokurori Special i republikës së Kosovës (PSRK-ja) ka paraqitur përgjigjen ndaj ankesave të avokatëve mbrojtës.

Më 21 qershor 2012, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK-ja) ka paraqitur mendimin e saj pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, duke propozuar hedhjen poshtë të ankesës së paraqitur në emër të akuzuarit *B.T.* si të papranueshme, refuzimin e ankesës së paraqitur në emër të akuzuarit *Nj-T.* si të pabazuar dhe vazhdimin e paraburgimit kundër *T.* derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë nëse kjo është e nevojshme për fazën e mëtutjeshme eventuale të procedurës.

2. Parashtresat e palëve

a) Ankesat

Avokati mbrojtës *H.M.* në emër të pandehurit *B.T.* bazon ankesën e tij në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe në vendimin mbi dënimin. Ai propozon anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës në rigjykim ose si alternativë të ndryshohet aktgjykimi duke e liruar të pandehurin nga akuzat, ose të shqiptohet një dënim më i butë. Përveç kësaj, ai kërkon që të ndërpritet paraburgimi ose si alternativë, të zëvendësohet me ndonjë masë më të lehtë sipas nenit 268 të KPPK-së.

Në veçanti, ai pretendon se dënimi i klientit të tij tejkalon kufijtë e aktakuzës pasi që në fjalën përfundimtare në seancën e mbajtur më 6 shkurt 2012 Prokurori ka ri-cilësuar veprën penale si detyrim në tentativë sipas nenit 267 paragrafëve 1 dhe 2 të KPK-së. Gjithashtu, aktakuza nuk specifikon veprimet individuale të klientit të tij me të cilat ai ka kryer veprën penale. Ai më tutje pohon se dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i pakuptueshëm, kundërtshënës në brendinë e tij dhe në kundërshtim me arsyetimin. Ai gjithashtu pohon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7, nenit 46 paragrafit 3 dhe nenit 156 paragrafit 2 të KPPK-së¹ duke mos i dhënë mundësinë mbrojtjes që të kundërshtoj deklaratat e palëve të dëmtuara gjatë fazës së hetimeve. Nuk ka ekzistuar asnjë arsye për ta arsyetuar caktimin e paraburgimit kundër *B.T.* Gjykata nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si jeta e mëparshme, sjellja dhe gjendja familjare e klientit të tij gjatë caktimit të dënimit.

Gjatë seancës ankimore, avokati mbrojtës përveç kësaj ka kërkuar që të marr dhe shqyrtoj video incizimet e hapësirave të Bankës BKT në Gjilan ku *B.T.* kinse ka kërcënuar palën e dëmtuar, *SH.Xh.* dhe ka bërë kërkesën e pretenduar. Përveç kësaj, ai qëndron pranë parashtresave të tij me shkrim të bëra në ankesë.

I pandehuri *B.T.* gjatë seancës ka mbështetur argumentet e avokatit të tij mbrojtës. Atij i vjen keq që ka pasur një keqkuptim në mes të babait të tij dhe palëve të dëmtuara. Kërkimi i huas është një gjë e zakonshme në mes të shqiptarëve në Kosovë. Ai

¹ Përmendja e 'KPK-së' si duket është gabim teknik.



asnjëherë nuk do ta kishte lejuar babanë e tij që të kërkoj hua nga palët e dëmtuara, po ta dinte këtë paraprakisht.

Avokati mbrojtës **M. M.** në emër të pandehurit **Nj. T.** kundërshton aktgjykimin P. Nr. 188/2011 të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan në bazë të shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimin mbi dënimin. Ai propozon anulimin e aktgjyimit të kontestuar dhe lirimin e të pandehurit, ose si alternativë, kthimin e lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim ose zvogëlimin e dënimit.

Në veçanti, ai pretendon se në fjalën përfundimtare PSRK-ja ka ndryshuar aktakuzën në atë mënyrë që vepra penale e pretenduar ka mbetur në tentativë dhe nuk ka përfunduar. Prandaj, gjykata nuk ka qenë e autorizuar që ta dënoj të akuzuarin për një vepër të përfunduar.

Ai gjithashtu pohon se dispozitivi është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij dhe në kundërshtim me arsyetimin. Ai konteston se gjykata nuk ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë. Në mënyrë më specifike, sipas mendimit të tij, gjykata nuk ka vërtetuar kontributin e pretenduar të klientit të tij në planin e përbashkët pasi që ai ka sqaruar në mënyrë bindëse se ai ka pranuar 2,000 Euro nga pala e dëmtuar, **Q. Xh.** vetëm si hua dhe asnjë kërcënim nuk është bërë për ta detyruar që t'i marr paratë. Kjo është provuar me anë të video incizimit në të cilin shihet se i akuzuari ka përshëndetur palën e dëmtuar në mënyrë të mirë dhe nuk shihet asnjë shenjë e veprimeve të kundërligjshme. Asnjë provë nuk është prezantuar e cila dëshmon se i akuzuari ka kontaktuar ndonjëherë **B. T.** për ta planifikuar detyrimin e pretenduar. Dënimi bazohet vetëm në deklaratën e palës së dëmtuar gjersa provat në dobi të të akuzuarit nuk janë marrë parasysh nga gjykata.

Ligji penal është shkalur pasi që veprimi i të akuzuarit – kërkimi i huas – nuk përbën vepër penale. Si rrjedhojë, dënimi i shqiptuar është i kundërligjshëm. I akuzuari asnjëherë nuk është dënuar më parë.

I pandehuri **Nj. T.** në seancën e Gjykatës Supreme ka sqaruar se ka kërkuar hua nga pala e dëmtuar sepse në të vërtetë ata janë miq të tij pasi që vajza e hallës së tij është e martuar me një anëtarë të familjes **Q.**

b) Përgjigja e PSRK-së ndaj ankesave

Prokurori Special i EULEX-it Maarit Loimukoski në përgjigjen e tij ndaj ankesave të mbrojtjes pohon se gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjykata në mënyrë të saktë ka vlerësuar kredibilitetin e dëshmive dhe ka bazuar gjetjet e saj faktike në deklaratat e dhëna nga palët e dëmtuara.

Pretendimet ankimore se aktgjykimi tejkalon aktakuzën janë të pabazuara. Aktakuza në mënyrë të qartë përshkruar veprimet inkriminuese të të dy të akuzuarve. Këto veprime janë verifikuar nga gjykata gjatë vërtetimit të gjendjes faktike.

Prokuroria gjatë deklaramit të fundit nuk e ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale në detyrim në tentativë, por argumentonte se nëse gjykata nuk i merr parasysh 2.000 eurot e siguruar si 'përfitim të madh material' në kuptim të nenin 267 paragrafit 2 të KPK-së,

duhet të marrë parasysh dënimin për tentim të dispozitës cilësuese të nenit 267 paragrafit 2 të KPK-së pasi që i akuzuari kishte kërkuar 20,000 Euros. Mirëpo, gjykata, siç thuhet në arsyetim, nuk i ka konsideruar 20,000 Euro si 'përfitim të madh material' në atë kuptim. Kjo përjashtoi mundësinë e të dënuarit për tentativë të dispozitës cilësuese të nenit paragrafit 2 të KPK-së. Pretendimi se mbrojtja nuk kishte pasur mundësi për t'i kundërshtuar deklaratimet e palës së dëmtuar është i pasaktë pasi që kjo mundësi u është dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokuroria mohon se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërtënie në vete apo me arsyetimin. Mbrojtja sa i përket kësaj nuk i ka provuar pretendimet e veta.

Gjykata po ashtu ka përcaktuar drejt dënimet në proporcion me peshën e veprës penale dhe sjelljen përkatëse dhe rrethanat personale të secilit kryerës.

c) Mendimi i ZPSHK-së

ZPSHK-ja propozon të hedhet poshtë ankesa e ushtruar në emër të të akuzuarit **B.T.** si e papranueshme, të refuzohet ankesa e ushtruar në emër të **N.T.** si e pabazuar dhe të vazhdohet paraburgimi ndaj **B.T.** deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë nëse kjo është e domosdoshme për një fazë eventuale të mëtutjeshme të procedurës.

ZPSHK-ja gjen se avokati mbrojtës i **B.T.** nuk ka arritur ta paralajmërojë ankesën e tij me kohë brenda tetë ditëve pas shpalljes së aktgjykimit dhe rrjedhimisht ka hequr dorë nga e drejta e tij për ankesë.

Faktet materiale të aktakuzës mbetën të pandryshuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Prandaj aktgjykimi nuk tejkalon aktakuzën. Dispozitivi nuk përmban dykuptimësi apo kundërtënie të brendshme ose kundërtënie me arsyetimin. Përmban të gjitha elementet dhe të dhënat e nevojshme dhe është i qartë dhe i kuptueshëm. ZPSHK-ja nuk gjen shkelje substanciale të procedurës penale. Mbrojtjes i është dhënë mundësia për ta mare në pyetje palën e dëmtuar gjete shqyrtimit gjyqësor.

Aktakuza asnjëherë nuk ka pretenduar se personi në videokasetë ishte **B.T.**, e as aktgjykimi në gjetjet faktike nuk ka arritur në përfundim të tillë. Prandaj gjykata e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike. Gjykata ka vërtetuar drejt dhe plotësisht gjendjen faktike duke u bazuar në përshtypjen e parë të provave të paraqitura. Gjykata e apelit nuk duhet ta zëvendësojë këtë vlerësim me të vetin. Prandaj pretendimi se prova ishte interpretuar jo në favorin e të akuzuarit nuk shërben si arsyetim i vlefshëm për ankesë.

Gjykata ka përcaktuar drejt dënimet në proporcion me peshën e veprës penale dhe sjelljen individuale dhe rrethanat personale të secilit të pandehur.

Sa i përket kërkesës për ndërprerjen e paraburgimit ndaj **B.T.** apo për zëvendësimin e tij me një masë më të butë, ZPSHK-ja i referohet aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pn.-Kr. 99/12, të datës 17 shkurt 2012, ku argumentet e njëjta të paraqitura nga mbrojtja u refuzuan si të pabazuara.

Në seancë Prokurorja e Shtetit shtoi se në rast se Gjykata Supreme gjen se ankesa **7.** është e pranueshme, propozohet se duhet të refuzohet si e pabazuar.



ndaj kërkesës së avokatit mbrojtës **H. M.**, ajo potencoi se incizimi i CCTV kamerave ka pak gjasa të kontribuojë si provë relevante pasi që incizimet e tilla kryesisht nuk përmbajnë audio incizime, por edhe nëse përmbajnë, sipas të gjitha gjasave nuk do të jenë të kuptueshme pasi që kërcënimet ishin bërë në zonë parkimi të ngarkuar gjatë ditës ku zhurma në prapavijë ndërhyr në çdo incizim. Po ashtu është ligjërish e panevojshme pasi që elementi konkret i veprës penale është dëshmuar me prova të tjera.

3. Gjetjet e Gjykatës

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesat e të dy të pandehurve janë të pranueshme por janë pa meritë.

a) Pranueshmëria

Shkresat e lëndës nuk përmbajnë asnjë provë se **B.T.** ka paralajmëruar ankesë paraprakisht. Neni 400 paragrafi 1 i KPPK-së i detyron personat me të drejtë ankese të paralajmërojnë ankesë jo më vonë se tetë ditë nga dita e shpalljes së aktgjykimit dhe paragrafi 2 i këtij neni përcakton se personi i cili nuk paralajmëron brenda afatit të paraparë ligjor konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, përveç në rastin nga paragrafi 4 i këtij neni. Paragrafi 4 ka të bëjë me rastet kur i akuzuari është dënuar me burgim. Pasi të dy të pandehurit gjykata e shkallës së parë i kishte dënuar me dënime me burgim, mungesa e paralajmërimit të ankesës nuk kishte çuar deri tek heqja dorë nga e drejta për t'u ankuar, siç përcaktohet me nenin 400, par. 2 të KPPK-së.

b) Vërtetimi i gjendjes faktike

Të dyja ankesat pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar nuk kishte konstatuar veprime individuale të të pandehurve përkatës me të cilat të njëjtit kishin kryer veprat penale të pohuara.

Gjykata konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar është mjaft specifik në përshkrimin e veprimeve të të dy të pandehurve dhe të gjitha elementeve të veprës penale të kryer, në dispozitiv si dhe në arsyetim dhe atë në mënyrë të detajuar, siç përcaktohet me nenin 391, lidhur me nenin 396 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar dëshmitë e dëshmitarëve, të palëve të dëmtuara dhe deklaratat e të dy të pandehurve. E njëjta ka vlerësuar besueshmërinë e burimeve në rastet kur pretendimet ishin kontradiktore me njëra tjetrën dhe ka ardhur deri tek përfundimi i drejtë.

Kontributi i **Nj.T.** në planin e përbashkët – thirrjet e tij telefonike, vizita në zyrën e **Q.Xh.** dhe pranimi i zarfit me paratë – dëshmohen nga dëshmia e dhënë nga pala e dëmtuar **Q.Xh.** si dhe nga video regjistrimet dhe të njëjtat janë vërtetuar me kallëzimin penal të datës 30 prill 2012 dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve **L.K.** dhe **A.B.**

Pohimi i të pandehurit se i njëjti kishte kërkuar hua nuk mbështetet nga aspekti logjik. Mbrojtja nuk mund të sqarojë për çfarë arsye palët e dëmtuara do të mundoheshin t'i akuzonin ata për vepër penale përkundër lidhjes së pohuar familjare në mes tyre si dhe pse do ta bënin një gjë të tillë, në qoftë se vërtet po kërkonin vetëm hua, atëherë pse të njëjtit

kishin vepruar me një insistim të tillë si dhe me një ndjenjë të tillë të natyrës urgjente, duke kontaktuar palën e dëmtuar disa herë gjatë vetëm një pasdite.

Lidhur me propozimin e avokatit mbrojtës *H.M.* për rishikimin dhe vlerësimin e regjistrimeve të bëra me kamerën monitoruese CCTV të Bankës BKT në Gjilan, gjykata konstaton se ka pak gjasa që e njëjta do të kishte ndonjë vlerë provuese lidhur me akuzën penale për arsyet e përmendura nga ZPShK-ja. Përveç arsyeve të përmendura teknike, të cilat tregojnë si të pak të mundshme që një regjistrim i tillë do të përmbante ndonjë audio regjistrim të dobishëm, provat e sugjeruara nuk janë prova të përshtatshme për t'i shfaqësuar të pandehurit. Edhe në rast se kamera monitoruese CCTV kishte regjistruar tërë periudhën kohore në fjalë, gjatë së cilës pala e dëmtuar *SH.Xh.* pohon se kishte qenë i kërcënuar nga i pandehuri *B.T.* ndërsa i pandehuri në fjalë nuk shfaqet në atë regjistrim, një gjë e tillë do të ishte e pamjaftueshme për të provuar se i pandehuri në fjalë nuk kishte qenë aty dhe nuk kishte bërë kërcënimet e përshkruara. Kontakti i përshkruar ka mund të ndodhte po ashtu edhe në pjesën tjetër të parkingut, pra në pjesën e cila nuk është e mbuluar nga kamerat. Fakti se i pandehuri *B.T.* vërtet kishte kërcënuar palën e dëmtuar në vendin që përshkruhet tashmë është vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme nga pala e dëmtuar si dhe gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmisë së *SP.Xh.* kundër dëshmimeve të të pandehurit *B.T.* pra Gjykata e Qarkut me te drejtë e ka vlerësuar si të vërtetuar.

c) Pohimet mbi shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Të dy të pandehurit pohojnë se dënimet i tejkalojnë kufijtë e akuzave. Gjykata konstaton se një pohim i tillë është i pabazë. Neni 386, paragrafi 1 i KPPK-së përcakton që aktgjykimi mund t'i përket vetëm të akuzuarit dhe vetëm akuzës e cila gjendet në aktakuzë. Të dyja ankesat pohojnë se akuzat fillestare për detyrim të kryera në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 27, paragrafët 1 dhe 2, lidhur me nenin 23 të KPK-së ndaj të dy të pandehurve ishin ndryshuar në seancën e datës 6 shkurt 2012 nga ana e prokurorisë, duke e ndryshuar akuzën në fjalë në thjesht detyrim në tentativë.

Gjykata në këtë drejtim qëndron plotësisht pas argumenteve të dorëzuara në përgjigjen ndaj ankesave të PSRK-së dhe në opinionin e ZPShK-së. Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 6 shkurt 2012 në mënyrë të qartë tregon se faktet materiale të aktakuzës kanë mbetur të pandryshuar. Prokurorja në fjalën e saj përmbyllëse vetëm kishte propozuar që në rast se gjykata e shkallës së parë nuk konstatonte se kalonte dispozita e neni 267, paragrafit 2 të KPK-së e cila duhej të zbatohet, për shkak të faktit se të 2,000 eurot e dorëzuara tek të pandehurit nuk paraqitnin 'përfitim të madh material', atëherë do të mund ta konsideronte si tentativë dispozitën e përmendur pasi që të pandehurit kishin kërkuar një shumë më të madhe sesa shuma prej 20,000 eurosh. Gjykata nuk ka nevojë që t'i përmbahet cilësimit juridik të veprës penale nga ana e prokurorisë. Gjykata ka shpallur të dy të pandehurit fajtorë vetëm për veprën penale të detyrimit në bazë të nenit 267, par. 1 të KPK-së përderisa nuk i ka shpallur të njëjtit fajtorë për dispozitën kaluese të paragrafit 2 të të njëjtit nen. Si rrjedhojë e kësaj që u tha, dënimet janë brenda kufijve të akuzave.

Këto ankesa po ashtu pohojnë se dispozita është e pakuptueshme, e paqëndrueshme nga brenda apo në mospërputhje me arsyet.

Mbrojtja ka dështuar në materializimin e pretendimeve të veta me argumentet e paraqitura. Gjykata konstaton se dispozitivi i përmban të gjitha elementet të cilat kërkeshen në nenin



396, paragrafët 3, 4 dhe 5 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka specifikuar në dispozitiv të dhënat personale të të pandehurve, ka përshkruar veprat penale të kryera, ka dhënë cilësimin juridik të veprave dhe dënimin. Gjykata ka theksuar kontributet individuale të të dy të pandehurve në realizimin e planit të përbashkët. Gjykata nuk gjen asnjë kontradiktë në mes të dispozitivit dhe të arsytimit.

Ankesa në emër të **B.T.** pretendon shkeljen e nenit 403, paragrafit 2, pikave 1 dhe 2 të KPPK-së pasi që mbrojtja pohohet se nuk kishte pasur mundësinë për t'i kundërshtuar dëshmitë e palëve të dëmtuara gjatë fazës së hetimeve. Gjykata e konsideron këtë pohim si të pabazë dhe thekson se ligji nuk njuh ndonjë detyrim të tillë. Neni 156, par. 2 i KPPK-së përcakton vetëm që mbrojtjes duhet t'i jepet mundësia që të sfidojë një dëshmitar '... gjatë ndonjë faze të procedurës penale.' Mbrojtja ka pasur një mundësi të tillë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

d) Pohimet mbi shkeljet e ligjit penal

Mbrojtja në ankesat e veta po ashtu kundërshton aktgjykimin mbi bazën e shkeljeve të ligjit penal. Një pretendim i këtillë bazohet në argumentin që veprimet e **Mj.T.** nuk përbëjnë vepër penale përderisa dënimi i **B.T.** bazohet vetëm në dëshminë e palëve të dëmtuara.

Gjykata u referohet këtyre gjetjeve në kapitullin 3. b) vërtetimi i gjendjes faktike. Gjykata ka marrë parasysh të gjitha provat e nevojshme dhe ka vlerësuar çdo provë në mënyrë të plotë, ashtu siç kërkohet me nenin 387, par. 2 të KPPK-së. Gjykata Supreme nuk gjen asnjë arsye për të dyshuar në rekonstruktimin e fakteve nga ana e gjykatës së shkallës së parë duke u bazuar në këtë rishikim dhe në këtë vlerësim të provave.

e) Vendimi mbi dënimin

Aktgjykimi është kundërshtuar me të dyja ankesat për shkak të vendimit të gabueshëm mbi dënimin.

Lidhur me **B.T.**, gjykata pajtohet plotësisht me konsideratat dhe me vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Lidhur me caktimin e dënimit për **Mj.T.**, gjykata konstaton se, duke u mbështetur në lartësinë e dënimit sipas nenit 267, par. 1 të KPK-së në mes të tre muaj dhe pesë vjet burgim, është dashur t'u jepet më shumë peshë rrethanave lehtësuese. Gjykata po ashtu vlerëson se i pandehuri nuk ka të kaluar kriminale. Sipas nenit 64, par. 1 të KPK-së, kolegji konstaton se burgimi prej një (1) viti është proporcional me kontributin e tij të dhënë në këtë vepër të përbashkët penale dhe me seriozitetin e kësaj veprë penale.

Duke u bazuar në argumentet e përmendura, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv.

